REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3599/1 Prot Elbasan më 30 /07/2025

# VENDIM

Nr 81 datë 23 /07/2025.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë pë muajin QERSHOR 2025**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin QERSHOR 2025, 79 familje me fond 235.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Sokol Sinani**

**Kryetar I Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë** 29.07.2025
**Pro** 37
**Kundër** —
**Abstenim** —

3593/2
04.08.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 835/1 **Prot** **Elbasan, më** 04.8**.2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.81, datë 29.07.2025 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Qershor 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – PREFEKTI I QARKUT

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

836
30.7.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3598/1 Prot Elbasan më 30/07/ 2025

**VENDIM**

Nr. 82 datë 29/07/2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin QERSHOR 2025**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **QERSHOR 2025** gjithsej 241 familje me një fond prej 1.168.635 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Sherbimit Social D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Sokol Sinani**

**Kryetar I Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë** 29.07.2025
**Pro** 37
**Kundër** —
**Abstenim** —

3598/2
04.08.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 836/1 **Prot** **Elbasan, më** 4.8.**2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.82, datë 29.07.2025 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**
**Ilir Bejtja**

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542138 prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 3060/1 prot Elbasan me 30.07.2025

# VENDIM

**Nr. 83, datë 29/07/2025**

**Mbi miratimin në parim të dokumentit strategjik: "Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030".**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29/07/2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, në mbështetje të nenit 28/1 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar,Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"Ligji Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë"Ligji nr 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore"Ligji Nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar" Ligji 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar Ligji 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar

## VENDOSI

1. Të miratojë në parim "Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030»

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi grupi i punës i ngritur me Urdhër Administrativ Nr.429 datë 18/06/2025 dhe Agjencia e Shërbimeve Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori DMPS E.Kolla

Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Buxhet-Financë A.Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Sokol Sinani**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi LALA**

3060/2
06.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 837/1 prot.

Elbasan, më 6.8.2025

**Lënda:** Konfirmim Akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.83 datë 29.07.2025, " Mbi miratimin në parim të dokumentit strategjik 'Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030' ", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Adresa: Lagja "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel: 054252138, www.prefektielbasan.gov.al E-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 3713/1 prot Elbasan me 30.07.2025

VENDIM

Nr. 84, datë 29/07/2025

**"Mbi miratimin e Raportit të Monitorimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024 ".**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29/07/2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, në mbështetje të nenit 28/1 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar,Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"Ligji Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë"Ligji nr 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore"Ligji Nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar" Ligji 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar Ligji 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar

VENDOSI

1. Të miratojë në parim "Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030»
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Sokol Sinani**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi LALA**

3713/2
06.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 338/1 prot. Elbasan, më 6.8.2025

**Lënda:** Konfirmim Akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.84 datë 29.07.2025, " Mbi miratimin e Raportit të Monitorimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

838
30.7.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3757/1 Prot. Elbasan, më 30.7.2025

**VENDIM**

**Nr. 85 datë 29.7.2025**

***"Për transformimin e Klubit Shumësportesh Elbasani në Organizatë Jofitimprurëse dhe miratimin e akteve për themelimin e saj"***

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 29.7.2025, duke marrë në konsideratë nevojat për zhvillimin e disiplinave të ndryshme sportive në territorin e Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Elbasan dhe Klubit Shumësportesh Elbasani, bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative në R. Sh." (i ndryshuar), në ligjin nr. 79/2017 "Për sportin" (i ndryshuar), në ligjin nr. 8788 datë 07.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), në ligjin nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" (i ndryshuar) si dhe në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar);

**V E N D O S I:**

1. Transformimin e Klubit Shumësportesh Elbasani në Organizatë Jofitimprurëse pa anëtarësi, në formën e Qendrës, me emërtimin "Klubi Shumësportesh Elbasani".
2. Të miratojë aktin e themelimit dhe statutin e këtij Klubi, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Bashkia Elbasan është themeluesi i vetëm i "Klubi Shumësportesh Elbasani".
4. Klubi Shumësportesh Elbasani do ketë logon dhe vulën e vet zyrtare, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Klubi Shumësportesh Elbasani do të zhvillojë aktivitetin e tij në adresën: Lagjja "28 Nëntori", Rruga "Esat Bordi", Pallati i Sportit "Tomorr Sinani", Elbasan, Shqipëri.
6. Punonjësit e Klubit Shumësportesh Elbasani emërohen dhe lirohen nga detyra në përputhje me

3757/2

06.08.2025

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

Nr. 839/1 prot. Elbasan, më 6.8.2025

**Lënda:** Konfirmim Akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.85 datë 29.07.2025, "Për transformimin e Klubit Shumësportësh Elbasani, në organizatë jofitimprurëse dhe miratimin e akteve për themelimin e saj", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

Adresa: Lagja "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel: 054252138, www.prefektielbasan.gov.al E-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3758/1 Prot. Elbasan, më 30.7.2025

**VENDIM**

*Nr. 86 datë 29.07.2025*

" Mbi transferimin e aseteve nga ish Agjencia e Kultures dhe Turizmit dhe ish Qendra e Artit tek Drejtoria e Kultures dhe Sporteve si dhe Drejtoria e Politikave te Turizmit dhe Trashegimise Kulturore,Bashkia Elbasan

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 29.07.2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithsme e Kulturës dhe Sportit " Mbi transferimin e aseteve nga ish Agjencia e Kultures dhe Turizmit dhe ish Qendra e Artit tek Drejtoria e Kultures dhe Sporteve si dhe Drejtoria e Politikave te Turizmit dhe Trashegimise Kulturore,Bashkia Elbasan", bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin finanaciar dhe kontrollin" (i ndryshuar) dhe në Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar),;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë transferimin e aseteve të Ish Agjencisë Kulturës dhe Turizmit dhe të Ish Qendra e Artit tek Drejtoria Përgjithshme Kulturës dhe Sporteve sipas përmbledhëses së inventarit fizik të mëposhtëm:

| Nr | Pershkrimi I aseteve | Asete ndare sipas klssifikimit ekonomik | | | | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 327 | 214 | 218 | 212 | |
| 1 | Biblioteka Q.Boholli | 11870677 | 1896433 | 3631339 | 11551601 | 28950049.8 |
| 2 | Muzeu Etnografik | 1156216 | 880222 | 5397603 | 9573980 | 17008021.1 |
| 3 | Biblioteka Femijeve | 466802 | 0 | 40000 | 0 | 506802.0 |
| 4 | Qerndra turistike dhe pista e parashutizmit Funar | | | | 23517837 | 23517837.0 |
| 5 | Itenerari si terheqje turistike Elbasan - Funar | | | | 5732530 | 5732530.0 |
| | **TOTALI (1-5)** | **13493695** | **2776655** | **9068942** | **50375948** | **75715240** |

| Nr | Pershkrimi I aseteve | Asete ndare sipas klssifikimit ekonomik | | | | | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 327 | 214 | 218 | 202 | 212 | |
| 1 | Qendra e Artit | 1.911.859 | 1.731.807 | 4.022.241 | 4.802.400 | 40.232.025 | 52.700.332 |
| 2 | Galeria e Artit | 361.027 | 1.919.497 | 512.679 | | 9.826.028 | 12.619.231 |
| | **TOTALI (1-2)** | **2.272.886** | **3.651.304** | **4.534.920** | **4.802.400** | **50.058.053** | **65.319.563** |

2. Të miratojë transferimin e aseteve të Ish Agjencisë Kulturës dhe Turizmi tek Drejtoria e Politikave te Turizmit dhe Trashegimise Kulturore,Bashkia Elbasan sipas përmbledhëses së inventarit fizik të mëposhtëm:

| Nr | Pershkrimi I aseteve | Asete ndare sipas klssifikimit ekonomik | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 327 | 214 | 218 | 212 | Shuma |
| 1 | Drejtori e politikave te Turizmit dhe trasgegimise kulturore | 7660 | | 98500 | | 106160 |
| | **TOTALI** | **7660** | **0** | **98500** | **0** | **106160** |

3. Të miratojë transferimin e aseteve të Ish Agjencisë Kulturës dhe Turizmi tek Agjencia e Mbikeqyrjes dhe Kontrollit sipas përmbledhëses së inventarit fizik të mëposhtëm:

| Nr | Pershkrimi I aseteve | Asete ndare sipas klssifikimit ekonomik | | | | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 327 | 214 | 218 | 212 | |
| 1 | AMK | 7250 | | 46900 | | 54150 |
| | | **7250** | **0** | **46900** | **0** | **54150** |

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Kultures dhe Sportit, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Sokol SINANI**

**KRYETARI**

**Lutfi LALA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN

**Konceptoi :**

*Spec/jurist: E.Koka*

*Prgj Sek Trashegimis Kulturore: D.Kristo*

*Dr drejtorie: K.Kapaj*

*Dr I pergjithshem: A.Kovaci*

3758/2
06.08.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 840/1 **Prot** **Elbasan, më** 5.8**.2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.86, datë 29.07.2025 "Mbi transferimin e aseteve nga ish Agjencia e Kulturës dhe Turizmit dhe ish Qendra e Artit tek Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve si dhe Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, Bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.3678/1 Prot.** **Elbasan, më: 30.07.2025.**

# V E N D I M

**Nr. 87 Datë: 29 .07.2025.**

***"Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik "Sistemim dhe asfaltim i rrugës "Qamil Lopari", ndodhur në Z.K 8526 dhe Z.K 2124"", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi"""*.**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 29 .07.2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike:

## V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e proçedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi projektit me interes publik *"Sistemim dhe asfaltim i rrugës "Qamil Lopari",ndodhur në Z.K 8526 dhe Z.K 2124""*. (planvendosje bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Sokol Sinani**

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

*Konceptoi: A. Braneshi* | *A. Pisha*
*Drejtoria P.P.S:* | *A. Suli*
*Drejtoria F.B.:* | *A. Merkja*
*Drejtoria P.U: E. Mihali* | *M. Avllazagaj*
*Drejtoria D.P.P.D.U:* | *K. Haxhihyseni*
*Drejtoria P.Sh.M:* | *S. Mehmeti*
*Drejtoria J. I:* | *A. Hoxha*
*Zv/Kryetar:* | *K. Krasnika*

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota kundër –

Vota Abstenim –

Zbardhur më datë_____/_____/2025

3678/2
08.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 1411 prot. Elbasan, më 08.08.2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.87 datë 29.07.2025 "Për miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive pronë private, për realizimin e projektit me interes publik "Sistemim dhe asfaltim i rrugës "Qamil Lopari", ndodhur në Z.K 8523 dhe Z.K 2124", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

842
30.7.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 3676/1 **Prot.** **Elbasan, më:** 30**.07.2025.**

# V E N D I M

**Nr.** 88 **Datë:** 28 **.07.2025.**

***"Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik "Sistemim dhe asfaltim i rrugës "Bajram Curri", nga intersektimi me rrugën "Vasil Llapushi" deri në intersektimin me rrugën "Iliaz Kosova" ndodhur në Z.K 8523"", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi"""*.**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 29.07.2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike:

## V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e proçedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi projektit me interes publik "*Sistemim dhe asfaltim i rrugës "Bajram Curri", nga intersektimi me rrugën "Vasil Llapushi" deri në intersektimin me rrugën "Iliaz Kosova" ndodhur në Z.K 8523""*. (planvendosje bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

**SEKRETARI**
**Sokol Sinani**

| | |
|---|---|
| *Konceptoi: A. Braneshi* | *A. Pisha* |
| *Drejtoria P.P.S:* | *A. Suli* |
| *Drejtoria F.B.:* | *A. Merkja* |
| *Drejtoria P.U: E. Mihali* | *M. Avllazagaj* |
| *Drejtoria D.P.P.D.U:* | *K. Haxhihyseni* |
| *Drejtoria P.Sh.M:* | *S. Mehmeti* |
| *Drejtoria J. I:* | *A. Hoxha* |
| *Zv/Kryetar:* | *K. Krasnika* |

Miratuar me 33 vota

Vota Pro 33

Vota kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur më datë_____/_____/2025

3670/2
08.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 8421 prot. Elbasan, më 08.08.2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.88 datë 29.07.2025 "Për miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik "Sistemim dhe asfaltim i rrugës "Bajram Curri", nga intersektimi me rrugën "Vasil Llapushi" deri në intersektimin me rrugën "Iliaz Kosova" ndodhur në Z.K 8523", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

843
30.7.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.3677/1 Prot.** **Elbasan, më: 30.07.2025.**

# V E N D I M

**Nr. 89 Datë: 29 .07.2025.**

***"Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pjesëve takuese të pronarëve privatë në pasurinë nr. 1/12 ndodhur në Z.K 8521, për realizimin e projektit me interes publik "Rikonstruksion i plotë i objektit "Teatri Skampa", në lagjen "Luigj Gurakuqi", Z.K 8521"", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi""".***

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 29 .07.2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike:

## V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e proçedurës së shpronësimit të pjesëve takuese të pronarëve privatë në pasurinë nr. 1/12 ndodhur në Z.K 8521, që preken nga realizimi projektit me interes publik "*Rikonstruksion i plotë i objektit "Teatri Skampa", në lagjen "Luigj Gurakuqi", Z.K 8521""*. (planvendosje bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pjesëve takuese të pronarëve privatë prekur nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

**SEKRETARI**

**Sokol Sinani**

*Konceptoi: A. Braneshi* *A. Pisha*
*Drejtoria P.P.S:* *A. Suli*
*Drejtoria F.B.:* *A. Merkja*
*Drejtoria P.U: E. Mihali* *M. Avllazagaj*
*Drejtoria D.P.P.D.U:* *K. Haxhihyseni*
*Drejtoria P.Sh.M:* *S. Mehmeti*
*Drejtoria J. I:* *A. Hoxha*
*Zv/Kryetar:* *K. Krasnika*

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur më datë_____/_____/2025

**Adresa:** ***Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al***

3677/2

08.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr.8431 prot. Elbasan, më 08.08.2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 " Për Prefektin e Qarkut ", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.89 datë 29.07.2025 " Për miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pjesëve takuese të pronarëve privatë në pasurinë nr. 1/12 ndodhur në Z.K 8521, për realizimin e projektit me interes publik " Rikonstruksion i plotë i objektit "Teatri Skampa", në lagjen "Luigj Gurakuqi", Z.K 8521, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi " konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

874
30.7.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 3675/1 Prot.** **Elbasan, më: 30.07.2025.**

# V E N D I M

**Nr. 80 Datë: 29.07.2025.**

***"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kalimin në pronësi të pasurisë nr.269 të llojit "rrugë" ndodhur në Z.K 3346, Njësia Administrative Gracen dhe regjistrimin e saj në emër të Bashkisë Elbasan".***

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 "*Për Kadastrën*"; ligjin nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*"; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 "*Për përcaktimin e proçedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve*", Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 29.07.2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike :

## V E N D O S I :

1. Miratimin për fillimin e proçedurave për kalimin në pronësi të pasurisë nr.269 të llojit *"rrugë"* ndodhur në Z.K 3346, Njësia Administrative Gracen dhe regjistrimin e saj në emër të Bashkisë Elbasan.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

**SEKRETARI**
**Sokol Sinani**

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

*Konceptoi: A. Braneshi* | *A. Pisha*
*Drejtoria P.P.S:* | *A. Suli*
*Drejtoria F.B.:* | *A. Merkja*
*Drejtoria P.U: F. Boja* | *M. Avllazagaj*
*Drejtoria D.P.P.D.U:* | *K. Haxhihyseni*
*Drejtoria P.Sh.M:* | *S. Mehmeti*
*Drejtoria J. I:* | *A. Hoxha*
*Zv/Kryetar:* | *K. Krasnika*

Miratuar me 33 vota

Vota Pro 33

Vota kundër –

Vota Abstenim –

Zbardhur më datë_____/_____/2025

3675/2
06.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 844/1 prot. Elbasan, më 5.8.2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr. 90 datë 29.07.2025 "Për miratimin e fillimit të procedurave për kalimin në pronësi të pasurisë nr.269, të llojit "rrugë", ndodhur në ZK 3346, Njësia Administrative Gracen dhe regjistrimin e saj në emër të Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. prot 3751/1 Dt. 30.07.2025

845 30.07.2025

**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 81, datë 28.07.2025

## PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË STUDIMIT TË POTENCIALIT TË ERËRAVE, ME SYNIM NDËRTIMIN E PARQAVE EOLIKE NË BASHKINË E ELBASAN

Këshilli bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë në lidhje me projekt-idene e hartuar nga subjekti i liçensuar për këtë qëllim "EU GREEN ENEREGY" Sh.p.k "*Për studimin e potencialit të erërave, me synim të ndërtimit të parqeve eolike*", në mbështetje të bazës ligjore të mëposhtëme:

a) Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 3, 4, 8, 9 dhe nenet 22 deri 28;
b) Ligjit nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "*Për pyjet*", i ndryshuar;
c) Ligjit nr. 7/2017 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*", i *ndryshuar*, i ndryshuar;
d) Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 433, datë 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar;
e) Udhëzimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.1, dt.9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

## VENDOSI

1. Të lejoj subjektin "*EU GREEN ENERGY*" Sh.p.k të bëj studimin e potencialit të erëave në territorin e bashkisë Elbasan nëpërmjet kullave Anemometrike provizore (*3 copë*) me sipërfaqe totale **0.6** ha në zonën e Krrabës për një periudhë **24** mujore (*sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi*).
2. Pagesa për përdorimin e fondit pyjor për efekt studimi do te jete sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "*Për çmimet dhe tarifat e përdorimit të fondit pyjor*", shtojca nr.1, pika 8 me vlerën totale 276,000 (*dyqind e shtatëdhjete e gjashtëmijë)* lekë.
3. I gjithë operacioni i instalimit të kullave anemometrike të kryhet nën mbikqyrjen e Specialistit të pyjeve për të pasur një zbatim rigoroz sipas projektimit dhe inpakt sa më minimal mbi mjedis.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (*sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*).

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Sokol Sinani**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

*Konceptoi:* *Q. Poka*
*Pranoi:* *J. Bodurri*
*Miratoi:* *K.Gripshi*

Miratuar me 35 vota
Vota Pro 35
Vota Kundër —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë ____/____/2025

3751/2
04.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
